



**AKT THEMELIMI**

**PER KRIJIMIN E SHOQERISE PER SHERBIMIN E ROJEVE CIVILE**

**" VJOSA-1 " Shpk PERMET**

"e mbeshtetje te Ligjit nr.7696 dt.07.04.1993 "Per sherbimin e rojeve civile si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne baze dhe per zbatim te tij, sot me dt.04.01.1999 une i nenshkruari :

- RIZA DANAJ, i biri i Muratit, lindur me 1952 ne Progonat tepelene dhe banues ne Permet, me vullnetin tim teplote , ne mbeshtetje te Ligjit 7633 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit 7667 dt.23.1.93 "Per rregjistrin tregtar" vendosa te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar (SH.F.K) si me poshte vijon :

MBENI 1 - Te formohet shoqeria private per sherbimin e rojeve civile me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin " VJOSA-1 " Shpk.

MBENI 2 - Shoqeria do te kete qendren e vet ne qytetin e Permetit.

MBENI 3 - Shoqeria do te kete nje kohezgjatje mbi 10 vjet pune te njepas njeshme. Ky afat mand te zgjatet me vendim te ortakut te vetem, por edhe te shkurtohet ne kushtet e shperberjes se shoqerise, sipas percaktimeve ne Statutin e shoqerise.

MBENI 4 - Themeluesi i shoqerise eshte z. Riza Danaj, i cili eshte edhe ortaku i vetem i saj.

MBENI 5 - Shoqeria tregtare " VJOSA-1 " Shpk kaper objekt te veprintarise se saj : Ruajtjen e objekteve qe jane ne pronesi ose ne perdorim te personave juridik apo fizik , shqiptar ose te huaj. Ruajtjen e rendit ne keto objekte dhe ruajtjen e jetes se personalit e te vlerave pasurore te tyre edhe gjate levizjeve.

MBENI 6 - Per fillimin e aktivitetit te shoqerise themeluesi ka depozituar nje kapital themeltar ne shumen 100.000 leke, shume e cila eshte prone vetjake e themeluesit.

MBENI 7 - Fitimi nga aktiviteti i shoqerise i perket teresisht administratorit Riza Danaj. Ky fitim do te disponohet lirisht prej tij pasi te jene shlyer detyrimet fiskale dhe ato ndaj te treteve.

MBENI 8 - Organi drejtues i shoqerise eshte administratori i saj z. Riza Danaj, i cili e perfaqeson juridikisht ate ne te gjitha organet apo organizmat shteterore apo private.

MBENI 9 - Shoqeria ka te drejte qe te punesoje specialiste ose punonjese te tjere me kontrate pune me shkrim sipas percaktimeve te legjislacionit te punes ne fuqi.

MBENI 10 - Do te konsiderohen veprintari e shoqerise vetem ato veprime juridiko civile qe do te kryhen nga organet ose punonjesit e saj konform disponimeve ne statutin e saj dhe ne mbeshtetje me legjislacionin ne

fuqi.

NEZI 11 - Veprimet ekonomike te shoqerise do te mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, me perjashtim te rasteve kur nje gje te tille e kerkon organi kompetent ligjor.

NEZI 12 - Shoqeria do te shperbehet sipas rasteve qe do te percaktohen ne statutin e saj.

NEZI 13 - Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis personave pjesmarres ose jo ne shoqeri do te zgjidhen me mirekuptim dhe ne rast se nje gje e tille nuk arrihet ato do te zgjidhen nga Gjykata kompetente sipas legjislacionit shqiptar.

NEZI 14 - Ky akt themelimi perpilohet ne kater kopje te barabarta ne gjuhen shqipe.

T H E M B L U R S I

RIZA DANAJ

*Riza Danaj*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. 6 RSP.  
NR. 5 KOL.



V E R T E T I M

Ne Tirane, sot me dt.04.01.1999 (nentedhje e nente), perpara meje noteres u paraqit personalisht z. Riza Danaj, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin AZ Nr.165699. Kerkoi vertetimin e nenskrimit te aktit te themelimit te shoqerise " VJOSA Shpk, per te cilin deklaroi se e ka hartuar me vullnetin e tij te lire dhe te plote jaste kesaj zyre. Nenshkroi rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E  
MARJETA BRISKU

*Marjeta Brisku*



# S T A T U T I

## I SHOQERISE PER SHERBIMIN E ROJEVE CIVILE

### " VJOSA-1 " SH.P.K



Une Riza DANAJ, nembeshtetje te aktit te themelimit te shoqerise " VJOSA-1 " Shpk, si ortak i vetem i saj, hartoj kete statut mbi bazen e te cilit do te ushtrohet aktiviteti i shoqerise per sherbimin e rojeve civile.

#### FORMA - EMRI

NENI 1 - Shoqeria do te jete nje shoqeri private me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "VJOSA-1" Shpk dhe e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar per shoqerite tregtare, per sherbimin e rojeve civile, mbi statutin e saj dhe aktin e themelimit.

#### KOHEZGJATJA

NENI 2 - Shoqeria krijohet per nje aktivitet me kohezgjatje mbi 10 vjet para afatit te percaktuar ne nenin 2 te ketij Statuti, pune te njepasnjeshme duke filluar ky afat nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane.

NENI 3 - Periudha e veprimtarise ekonomike mund te zgjatet me vendim te administratorit themelues te shoqerise si ortak i vetem i saj ose mund te shkurtohet ne rastin kur do te vertetohet shperberja e shoqerise

#### QENDRA E SHOQERISE

NENI 4 - Shoqeria selinee saj e ka ne qytetin e Permetit Administratori i saj ka te drejte qe te ndryshoje vendin e qendres se shoqerise. Shoqeria me vendim te administratorit te saj mund te cele vendqendrim te dyta operative.

NENI 5 - Shoqeria mund te cele dege te saj edhe ne qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte saj. Keto dege do te krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe te vendeve ku do te ngrihen.

NENI 6 - Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj duke patur ne perdorim nje vule ne forme te percaktuar ku do te shenohet emri si dhe qendra e aktivitetit te shoqerise.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 7 - Shoqeria "VJOSA-1" Shpk ka per objekt te veprimtarise se saj :

- Ruajtjen e objekteve qe jane ne pronesi ose perdorim te personave juridik apo fizik, shqiptar ose te huaj.

- Ruajtjen e rendit ne keto objekte dhe ruajtjen e jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjeve.

ENI 8 - Administratori i shoqerise si ortak i vetem i saj ka te drejte te zgjeroje aktivitetin ne te ardhmen brenda kuadrit te veprimtarise se shoqerise duke lidhur kontrata apo akt marreveshje me persona fizik ose juridik, vendas ose te huaj.

ENI 9 - Do te konsiderohen veprimtari te shoqerise vetem ato veprime juridiko civile qe do te kryhen nga organet ose punonjesit e saj konform disponimeve ne kete statut dhe kurdohere ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.

#### KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

ENI 10 - Per fillimin e aktivitetit te shoqerise administratori themelues si ortak i vetem i saj ve nje kapital themeltar qe kap shumen prej 100.000 leke, shume e cila eshte kontribut dhe prone vetiake e tij.

ENI 11 - Per administrimin dhe qarkullimin e kapitalit te shoqerise hapet edhe nje llogari rrjedhese dhe likujduese . Kapitali themeltar i shoqerise eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie ose ne forme shitje. Tjetersimi i pasurise ne keto raste do te behet sipas kriterëve te percaktuara ne ligj.

ENI 12 - Shoqeria kate drejte qe te lere peng me vendim te administratorit te saj teresisht ose pjeserisht kapitalin e saj themeltar kur nje veprim i tille do te cmohet me leverdi ekonomike per interesat e shoqerise.

ENI 13 - Shoqeria ka te drejte qe sipas nevojave qe mund ti paraqiten gjate ushtrimit te aktivitetit te saj te bleje dhe te shfrytetoje te drejta te tjera materiale. Ajo ka te drejte te leshoje me qira pasurite e saj.

ENI 14 - "jithe fitimi i realizuar ngaaktiviteti i shoqerise i perket ortakut te vetem te saj z.Riza Danaj, ky fitim do te perdoret lirisht pasi te jene shlyer me pare detyrimet fiskale dhe ato ndaj te treteve.

#### ORGANET DREJTUESKE TE SHOQERISE

ENI 15 - Organ drejtues dhe vendimor ne kete shoqeri eshte administratori i saj z.Riza Danaj, i cili e perfaqeson juridikisht ate ne te gjitha organet apo organizmat e aparatit shteteror si dhe ne maredheniet me te treta kur veprimet kane te bejne me disponimin e interesave materiale te shoqerise.

ENI 16 - Me akt perfaqesimi te leshuar ngaadministratori, shoqerine mund ta perfaqesoje cdo person tjeter.

ENI 17 - Administratori i shoqerise ka keto te drejta dhe detyrime kryesore :

- Organizon punen dhe perfaqeson shoqerine.
- Lidh dhe nenshkruan kontrata si dhe akte te tjera.
- Ben caktimin e punonjesve ne vendet e punes.
- Jep masa disiplinore.
- Ujdeset per zbatimin e dispozitave ligjore, dispozitave te ketij statuti dhe akteve ligjore e nenligjore qe kane lidhje me veprimtarine e shoqerise.

NEENI 18 - Per drejtimin administrativ te shoqrise, pronari i saj mund te emeroje ose punesoje nje drejtor ekzekutiv, i cili ka per detyre qe te marre te gjitha masat organizative per te siguruar kryerjen normale te te gjitha veprimtarise ekonomike operative dhe mban pergjegjesi per mosarritjen e rezultateve sipas rasteve te parashikuara ne kontraten e punesimit ose neligj.

#### ADMINISTRIMI, VITI FINANCIAR, BILANCI

NEENI 19 - Mjetet e investuara ne shoqeri si dhe ato te shtuara nga akti viteti i saj rregjistrohen ne librin e llogarivete shoqerise. Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive ne emer te vet ne perputhje meqellimin dhe objektin e veprimtarise se saj.

NEENI 20 - Shoqeria shfrytazon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financimi per zhvillimin e saj, per nxitjen ekonomike, etj. Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera, kur detyrimet nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

NEENI 21 - Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Logarite vjetore, raportet ne lidhje me operacionet financiare dhe cdo raport tjeter ne kete drejtim, miratohen nga administratori i shoqerise brenda 3 muajve dhe ne cdo rast jo me vone se 3 muaj nga data e mbylljes se vitit.

#### PUNESIMI NE SHOQERI

NEENI 22 - Per realizimin e aktivitetit te saj shoqeria mund te punesoje specialiste ose punonjes te ndryshem me kontrate pune me shkrim sipas percaktimeve ne legjislacionin per maredheniet e punes. Ne sherbimin e rojes civile shoqeria do te pranoje vetem ata persona qe do te plotesojne kushtet dhe kerkesat e n.5 te Ligjit nr.7696 dt.07.04.1993.

NEENI 23 - Marrja ne pune e punonjesve do te behet nga shoqeria sipas nevojave te saj duke patur parasysh aftesite fizike, arsimore e profesionale te te punesuarve. Rojet civile kjo shoqeri i perzgjedh dhe nga ata qe duan te punojne si te tille megjithese ajo eshte e detyruar qe pa

ra marrjes ne pune te siguroje per ta licencen e ushtrimit te profesionit nga organi i rendit publik Permet.

NENI 24 - Maredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes, te cilat mund te jene kolektive ose individuale.

NEF ceshtjet qe nuk rregullohen me kontrate zbatohen dispozitat e Kodit te Punes si dhe aktet e tjera ligjore e nealigjore qe rregullojne keto maredhenie.

NENI 25 - I punesuari nuk marr pjese ne ndarjen e fitimit qe realizohet nga shoqeria gjate ushtrimit te aktivitetit te saj apo edhe ne humbjet esaj. Ai pergjigjet materialisht per demet qe i shkaktohen shoqerise me faj te tij ( me dashje apo nga pakujdesia).

#### SEKRETI AFARIST I SHOQERISE

NENI 26 - Sekret afarist konsiderohen dokumentat dhe te dhenat, te cilat jane me rendesi per punet e shoqerise. Komunikimi i tyre personave te pa autorizuar per shkak te rendesise se tyre do te ishte ne kundershtim me interesat e shoqerise. Te dhenat dhe dokumentat te cilat konsiderohen sekret afarist mund tju komunikohen personave te tjere vetem nga administratori i shoqerise.

#### MARREDHENIET KONTRAKTORE TE SHOQERISE

NENI 27 - Shoqeria per sherbimin e rojeve civile duke qene person privat per ruajtjen e objekteve ne pronesi ose ne perdorim si dhe per ruajtjen e rendit ne keto objekte do te marre persiper detyrime dhe do te lidhe kontrata brenda kufijve te percaktuara nga ligji me persona te ndryshem fizik apo juridik, shqiptar ose te huaj.

NENI 28 - ne keto kontrata do te parashikohen dhe saktesohen objektet qe do te ruhen me roje civile, shpenzimet per ruajtjen e objekteve, si dhe detyrimet per mosrespektimin e situates.

NENI 29 - Per kontraten qe do te lidhe me degen e rendit publik duhet te parashikohen edhe detyrimet e meposhteme :

- Pajisja e rojeve meuniforme, - pajisja e rojeve civile me armatime,
- pajisja e rojeve civile me leje arme dhe dokumenta identifikimi,
- testimi i rojeve civile si dhe mbulimi i shpenzimeve per pajisjen e rojeve civile, - zbatimi i kerkesave te organit te rendit publik per njoftimin e ngjarjeve, - detyrimi per mosrespektimin e kontrates.

#### SHPERBERJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 30 - Shoqeria mund te shperbehet ne rastet :

- me vendim te administratorit te saj kur per dy vjet rradhazi shoqeri nuk rezulton rentabel,

- me plotesimin e afatit te kohezgjatjes se aktivitetit teshoq rise,  
- ne rast falimentimi ekonomik,  
- ne ato raste kur shprehimisht do te cutohet nje gje e tille nga legjislacioni ne fuqi.

NEUNI 31 - Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit te saj qysh ne momentin e prisnjes ose te shperberjes.

Pas shlyerjes se detyrimeve tatuese fiskale dhe ato ndaj te treteve percaktohen pasurite e ngelura te cilat i kthehen teresisht administratorit te shoqerise qe eshte dhe pronar i vetem i saj.

DISPOZITA TE PERQJITHSHME

NEUNI 32 - Mosmarreveshjet juridiko civile te lindura midis personave pjesmarres ose jo ne shoqeri, kur nuk mund te zgjidhen me mirekuptim me njeri tjetrin do te zgjidhen nga Gjykata e rrethit Tirane ose cdo gjykate tjeter kompetente sipas legjislacionit shqiptar.

NEUNI 33 - Ky statut perpilohet ne kater kopje te barabarta ne gjuhen shqipe dhe hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te shoqerise ne Gjykatën e rrethit Tirane.

"je kopje e ketij statuti do te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise " VJOSA Shpk.

Permet, me 28.12.1998

ORTAKU I VETEM I SHOQRISE

RIZA DANAJ

RIZA DANAJ

